

AKTI I THEMELIMIT
TE SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"ANTENA Sh.p.k"



Ne ortaket:

- Z. Emanouil Papadopoulos, shtetas helen lindur ne Selanik me 23.09.1978, i biri i Jorgos, mbajtes i pasaportes greke nr M 911684, banues ne Selanik, Greqi:
-Znj Anita Ibraj, shtetas shqiptare, lindur ne Bilisht me 08.03.1971, mbjatese e pasaportes shqiptare me nr 0922784, banuese ne Tirane, Shqiperi;
- Z.Bledar Demiri, shtetas shqiptar, lindur ne Devoll, Shqiperi me 11.07.1978, mbajtes i pasaportes shqiptare me nr. 1905252, banues ne Tirane, Shqiperi.

Mbeshtetur ne ligjin 7638, dt 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregetare", krijojme shoqerine me pergjegjesi te kufizuar ANTENA Sh.p.k..

Personat e e siperpermendur gezojne zotesi te plote Juridike per te vepruar, dhe,

VENDOSIN

1. Te themclojne nje Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar me emertimin "ANTENA Sh.p.k.". Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe me kete Akt Themelimi e Statutin e saj.

Shoqeria do te kete per objekt:

- Krijimin, funksionimin, shfrytezimin e nje stacioni radiofonik (fm) lokal, e cila perfshin prodhimin, transmetimin dhe ritransmetimin e programeve argetuese radiofonike, informacione me anc te zerit te destinuara per publikun;
- perfaqesimin e subjekteve juridike vendase apo te huaja me objekt te ngjashen ne territorin e Republikes se Shqiperise;
- Si dhe çdo veprimtari tjeter ekonomike qe do te konsiderohet e nevojshme dhe e dobishme per realizimin e qellimit te shoqerise e qe nuk bie ndesh me legjislacionin shqiptar ne fuqi.

Haydinni Law Office



Shoqeria ANTENA Sh.p.k. e ka seline e saj ne adresen: Bulevardi "Bajram Curri." Pallatet e Aviacionit, Pall.10.Shk. 11. Ap. 4. Tirane, Shqiperi.

Shoqeria mund te hape filiale, degje dhe zyra perfaqesimi ne qytete te tjera te Republikes se Shqiperise dhe/ose jashte saj.

2. Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje afat kohor te papercaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne Regjistrin Tregtar Shqiptar.
3. Kapitali Themeltar i shoqerise eshte 100.000 (njqindmije) Leke shqiptare dhe ndahet ne 100 kuota me vlere nominale 1.000 (njemije) Leke secila. Kapitali i shoqerise eshte teresisht i nenshkruar dhe i derdhur ne te holla perkatesisht nga ortakët:
 - Ortaku Emanouil Papadopoulos, 39 kuota me vlere te pergjithshme 39.000 (tridhjetë e nente mije) Leke baraz me 39% te kapitalit te shoqerise;
 - Ortaku Anita Ibraj, 31 kuota me vlere te pergjithshme 31.000 (tridhjetë e nje mije) Leke baraz me 31% te kapitalit te shoqerise;
 - Ortaku Bledar Demiri, 30 kuota me vlere te pergjithshme 30.000 (tridhjetë mije) Leke baraz me 30% te kapitalit te shoqerise;
4. Shoqeria do te administrohet nga nje Administrator i Vetem. Administratori i Vetem do te qendroje ne detyre deri ne momentin e revokimit te mandatit tij nga Asambleja e Ortakeve. Administratori ka te drejte t'u delegoje personave te trete te emeruar prej tij, nje pjese apo te gjitha te drejtat e kompetencat qe i njihen atij nga Statuti i shoqerise dhe nga ligji shqiptar ne fuqi. Administrator i Vetem i shoqerise do te jete Z. Emanouil Papadopoulos, shtetas helen, lindur ne Selanik, Greqi me 23.09.1978, mbajtes i pasaportes helene me nr.M 911684, banues ne Selanik,Greqi.
5. Viti financiar i shoqerise fillon me 1 janar dhe perfundon me 31 dhjetor te çdo viti. Perjashtimisht, viti


i pare financiar fillon ne ditën e regjistrimit të shoqërisë në Regjistrin Tregtar dhe perfundon me 31 dhjetor 2003.

Ky Akt i Themelimit të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar ANTENA Sh.p.k. përpiqet në pesë kopje në gjuhën shqipe dhe nënshkruhet nga ortakët, unë Noteri e vertetë sipas ligjit.

ORTAKET

1. EMANOUIL PAPADOPOULOS

perfaqesuar me Prokure nga Nikos Papadopoulos

PAPADOPOULOS NIKOS 

2. ANITA IBRAJ

perfaqesuar me prokuror nga Gërgji Shemko



3. BLEDAR DEMIRI

Bledar Demiri



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE

Nr. 5670 Rep.
----- Kol.

PULLE TAKSE

100
LEKE

VERTETIM

Ne Tirane, sot me 09.12.2002, perpara meje, Noterit te Dhomes se Notereve Tirane, Eqerem Gaxholli, u paraqit personalisht Z. Bledar Demiri, per identitetin e te cilit u sigurova nga dokumentet identifikuese qe ai mban, dhe Znj. Anita Ibraj e perfaqesuar me prokure te posacme nga Z. Gjergji Shemko dhe Z. Emmanouil Papadopoulos I perfaqesuar me prokure te posacme nga Z. Nikos Papadopoulos.

Pasi une Noteri, i lexova dhe i shpjegova **Aktin e Themelimit**, bashkengjitur ketij vertetimi, ata me deklaruan se e kuptojne, e pranojne dhe se e ka hartuar ate ne perputhje te plote me vullnetin e tyre te lire, dhe e nenshkruajne rregullisht para meje Noterit, gje te cilen e vertetoj sipas ligjit shqiptar.



NOTER
Egerem Gaxholli
EQEREM GAXHOLLI

STATUTI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"ANTENA SH.P.K"



Permbajtja.

Emertimi - Forma - Baza Ligjore *Nenet 1- 3*


Objekti - Selia *Nenet 4- 7*

Kohezgjatja - Kapitali *Nenet 8- 11*

Organet e Shoqerise *Nenet 12- 17*

Viti Financiar - Likujdimi *Nenet 18- 19*

Norma Referuese - Kompetenca *Nenet 20- 22*



STATUTI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"ANTENA SH.P.K"

EMERTIMI - FORMA - BAZA LIGJORE

Neni 1.

Ortaket themelues:

- Z. Emanouil Papadopoulos, shtetas helen lindur ne Selanik me 23.09.1978, i biri i Jorgos, mbajtes i pasaportes greke nr M 911684, banues ne Selanik, Greqi;
- Znj Anita Ibraj, shtetas shqiptare, lindur ne Bilisht me 08.03.1971, mbjatese e pasaportes shqiptare me nr 0922784, banuese ne Tirane,Shqiperi;
- Z.Bledar Demiri, shtetas shqiptar, lindur ne Devoll, Shqiperi me 11.07.1978, mbajtes i pasaportes shqiptare me nr. 1905252, banues ne Tirane, Shqiperi.

me date 10.12.2002, kane themeluar nje Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar me emertimin "ANTENA Sh.p.k."

Haydinni Law Office





Neni 2.

Shoqeria fiton personalitet juridik nepermjet vendimit per rregjistrim te saj ne rregjistrat tregetar ne Gjykatën e Rrethit Tirane.

Neni 3.

Shoqeria e zhvillon aktivitetin e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe me dispozitat e parashikuara nga ky Statut dhe Akti i Themelimit te saj.

OBJEKTI - SELIA

Neni 4.

Shoqeria ka per objekt:

- Krijimin, funksionimin, shfrytezimin e nje stacioni radiofonik (fm) lokal, i cili perfshin prodhimin, transmetimin dhe ritransmetimin e programeve argetuese radiofonike, informacione me ane te zerit te destinuar per publikun;
- perfaqesimin e subjekteve juridike vendase apo te huaja me objekt te ngjashen ne territorin e Republikes se Shqiperise;
- Si dhe çdo veprimtari tjeter ekonomike qe do te konsiderohet e nevojshme dhe e dobishme per realizimin e qellimit te shoqerise e qe nuk bie ndesh me legjislacionin shqiptar ne fuqi.



Neni 5.

Shoqeria e ka seline e saj ne adresen: Bulevardi "Bajram Curri.", Pallatet e Aviacionit, Pall.10.Shk.
11. Ap. 4. Tirane, Shqiperi.

Neni 6.

Adresa e ligjshme e ortakeve per çdo raport me shoqerine eshte selia e shoqerise.

Neni 7.

Shoqeria mund te hape filiale, dege e zyra perfaqesimi ne qytete te tjera te Republikes se Shqiperise dhe/ose jashte saj.

KOHEZGJATJA - KAPITALI

Neni 8.


Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje afat kohor te papercaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne Regjistrin Tregtar shqiptar.

Neni 9.

Kapitali Themeltar i shoqerise eshte 100.000. (dyqindmije) Leke shqiptare dhe ndahet ne 200 kuota me vlere nominale 1.000 (njemije) Leke secila. Kapitali i shoqerise eshte teresisht i nenshkruar dhe i derdhur ne te holla perkatesisht nga ortaket:

Haydinni Law Office





Ortaku Emanouil Papadopoulos, 39 kuota me vlere te pergjithshme 39.000 (tridhjetë e nente mijë) Leke baraz me 39% te kapitalit te shoqerise;

- Ortaku Anita Ibraj, 31 kuota me vlere te pergjithshme 31.000 (tridhjetë e një mijë) Leke baraz me 31% te kapitalit te shoqerise;

- Ortaku Bledar Demiri, 30 kuota me vlere te pergjithshme 30.000 (tridhjetë mijë) Leke baraz me 30% te kapitalit te shoqerise;

Neni 10.

Kuotat jane lirisht te transferueshme sipas ligjit shqiptar ne fuqi. Pas ezaurimit te te drejtes se parapelqimit nga ortaket egzistues, me vendim te Asamblese te Pergjithshme me shumice prej 60% te kapitalit themeltar vendoset mbi kadidatin e sukseshem per blerje.

Neni 11.

Ortaket e shoqerise pergjigjen per detyrimet kundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tyre ne kapitalin e saj.



ORGANET E SHOQERISE

Neni 12.

Asambleja e Ortakeve, ligjerisht e thirrur dhe rregullisht e mbledhur, perfaqeson unanimitetin e ortakeve dhe eshte organi suprem i shoqerise. Vendimet e saj te nxjera konform ligjeve dhe ketij statuti detyrojne te gjithë ortaket edhe pse jo te pranishem ose kundra.

Asambleja duhet te mblidhet te pakten nje here ne vit brenda gjashte muajve nga mbyllja e vitit financiar te shoqerise.

Data, vendi dhe rendi i dites se mbledhjes se asamblese do t'u kominkohet ortakeve nepermjet fteses me shkrim, te pakten 15 dite perpara.

Neni 13.

Asambleja e Ortakeve thirret nga Administratori i Vetem ose nga nje a me shume ortake qe perfaqesojne te pakten 60% te kapitalit te shoqerise.

Vendimet e Asamblese se Ortakeve ne mbledhje te zakonshme jane te vlefshme kur aprovohen nga nje a me shume ortake qe perfaqesojne 60% ne kapitalin e shoqerise.


Vendimet e Asamblese se Ortakeve ne mbledhje te jashtezakonshme jane te vlefshme kur aprovohen nga nje a me shume ortake qe perfaqesojne te pakten 80% te kapitalit te shoqerise.

Ne rast perseritje te Asamblese per shkak te mos arritjes te quorumit apo te shumices se nevojshme per marrjen e vendimeve te vlefshme, nje shumice prej 60% te kapitalit te shoqerise konsiderohet e pranueshme.

Neni 14.

Asambleja e Ortakeve aprovon llogarite dhe bilancin e Shoqerise te komunikuar nga Administratori i Vetem brenda gjashte muajve nga mbyllja e vitit financiar dhe vendos mbi ndarjen e te ardhurave.





Neni 15.

Shoqeria administrohet nga Emanouil Papadopoulos, Administratori i Vetem, i cili do te emerohet nga Asambleja e Ortakeve.

Administratori i Vetem do te qendroje ne detyre deri ne momentin e revokimit te mandatit tij nga Asambleja e Ortakeve.

Administratori mund t'u delegeje personave te trete te caktuar prej tij, nje pjese apo te gjitha kompetencat e tij, me ane te nje prokure e cila eshte objekt aprovimi nga Asambleja e Ortakeve me shumice prej 60% e njejta procedure ndiqet edhe per revokimin e kesaj prokure.

Administratori pergjigjet personalisht perballe shoqerise dhe/ose te treteve per shkeljet e mundshme te ligjit dhe/ose te statutit.

Neni 16.


Administratori mund te shkarkohet ne çdo moment me vendim te Asamblese se Ortakeve, te aprovuar nga nje ose me shume ortake qe perfaqesojne 60% e kapitalit te shoqerise.

Gjithashtu, Administratori mund te shkarkohet ne çdo moment me vendim te autoritetit gjyqesor shqiptar, per shkelje te ligjit.

Neni 17.

Eksperti kontabel, ne rastet kur ligji e kerkon detyrimisht emerimin e tij, ai emerohet dhe vepron ne perputhje me ligjin.





VITI FINANCIAR I SHOQERISE - LIKUJDIMI

Neni 18.

Çdo vit financiar i shoqerise fillon me 1 janar dhe mbaron me 31 dhjetor te çdo viti.
Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon ne ditën regjistrimit te shoqerise ne Regjistrin Tregtar dhe mbyllet ne 31 dhjetor 2003.

Neni 19.

Ne çdo moment e per çdo arsye qe arrihet ne shperndarjen e shoqerise, normat per kryerien e likujdimit dhe emerimin e likuidatorit ose likuidatoreve do te vendosen nga Asambleja e Ortakeve sipas dispozitave te ligjit shqiptar ne fuqi.

NORMA REFERUESE - KOMPETENCA

Neni 20.

Per sa nuk parashikohet ne kete Statut behet referim ne ligjet shqiptare ne fuqi ne fushen e shoqerive tregtare.

Neni 21.

Autoriteti gjyqesor ne Republiken e Shqiperise ka kompetenca ekskluzive per zgjidhjen e te gjitha mosmarreveshjeve qe mund te lindin midis ortakeve, midis ketyre e organeve te shoqerise ose shoqerise.

Neni 22.

Ky Satut i Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar ANTENA Sh.p.k. perpilohet ne pese kopje ne gjuhen shqipe dhe tre kopje ne gjuhen greke me te njejten vlere secila, qe nenshkruhen rregullisht nga ortaket.

ORTAKET

1. Gjergji Shemko



2. Bledar Pemisi



3. PAPADOPOVLO NIKOS

